

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT  
SEKSIONI I TRETË

**VENDIM**  
**Kërkesa nr. 14918/06**

**Kristo Lepuri**  
**kundër Shqipërisë**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 11 tetor 2022, si Komision, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

Pasi mori në konsideratë:

kërkesën (nr. 14918/06) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 5 prill 2006 nga një shtetas shqiptar, Kristo Lepuri (“kërkuesi”), lindur në vitin 1942 dhe banor në Tiranë, i përfaqësuar nga z. A Hakani, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për t’ia përcjellë kërkesën Qeverisë shqiptare (“Qeveria”), fillimisht e përfaqësuar nga Agjentja e saj, znj. S. Meneri, dhe më pas nga z. O. Moçka, nga Zyra e Avokatit të Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

**LËNDA E ÇËSHTJES**

1. Kërkesa ka të bëjë me një shkelje të pretenduar të parimit të së drejtës së armëve, në mbështetje të nenit 6 të Konventës, si rezultat i statusit të kërkuesit si palë e tretë në procedurat gjyqësore vendase dhe pretendimit për mungesë të paanshmërisë së Gjykatës së Apelit. Në vijim, ai ngre çështjen nëse të drejtat e kërkuesit ndaj pronës, në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, ishin shkelur nga konstatimi i gjykatave vendëse se një kontratë shitblerje me anë të së cilës kërkuesi kishte përfutur të drejtat e pronësisë ndaj një pallati dhe toke, ishte e pavlefshme.

2. Kërkuesi dhe pasardhës të tjerë morën pronësinë e dy trojeve dhe një godinë dykatëshe (një ish-çerdhe për fëmijë) e ndërtuar në njërin prej trojeve, fillimisht me anë të një vendimi të datës 8 shkurt 1996 të Komisionit për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave (“Komisioni”), dhe më pas me anë të zbatimit të tij më 27 prill 1999, me anë të privatizimit të tokës, kur kërkuesi lidhi një kontratë të noterizuar me Autoritetin Kombëtar të Strehimit (në vijim referuar si “AKS”) për blerjen e një apartamenti me tri dhoma gjumi, i cili ishte pjesë e çerdhes, si edhe truallin përkatës me një sipërfaqe prej 175 m<sup>2</sup>, në përputhje me ligjin për privatizimin e banesave shtetërore. Kërkuesi pagoi 189,000 lekë (ALL). Kontrata e blerjes u regjistrua në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (“ZRPP”) si “regjistrimi nr. 42, i datës 28 maj 1999”.

3. Procedurat u zhvilluan pranë Gjykatës së Rrethit Sarandë (“Gjykata e Rrethit”) kundër Komisionit nga L. (një individ privat), i cili pretendonte të kishte të drejta pronësore konkurruese kundrejt truallit të sipërpërmendur të kërkuesit dhe kërkonte që të njëjti si pronar (*restituto in natura*). Kërkuesi mori pjesë në procedura si palë e tretë. Gjykata e Rrethit (e mbledhur si një trup gjykues me gjyqtarë ku përfshihej edhe P.K.) gjykoi pjesërisht në favor të L., duke ndikuar në këtë mënyrë mbi të drejtën pronësore të kërkuesit. Më 29 janar 2002, Gjykata e Apelit Gjirrokastër, e mbledhur si një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë, ku përfshihej edhe T.S. dhe M.Q., la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit konstatuan se kërkuesi nuk kishte e kishte përfutur truallin në fjalë në kohën e privatizimit të çerdhes. Më 17

qershor 2003, Gjykata e Lartë rrëzoi të dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e kundërshtoi pretendimin e L. si të pabazuar.

4. Gjatë procedurave të ngjashme të mëpasshme në Gjykatën e Rrethit Sarandë ndërmarrë kundër Komisionit nga R. (një tjetër individ privat), i cili kërkonte të drejta pronësore konkurruese kundrejt truallit të sipërpërmendur të kërkuarit, ky i fundit u thirr përsëri të merrte pjesë si palë e tretë. Gjatë gjithë procedurave, kërkuari u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur prej tij. Kundërpadia e tij, e cila do të kishte kërkuar pjesëmarrjen e tij në procedura si i akuzuar, u rrëzua në mënyrë që të shqyrtohej në procedura të veçanta për të shmangur vështirësi të dukshme, sipas fjalëve të përdorura nga Gjykata e Rrethit.

5. Më 22 shtator 2003, Gjykata e Rrethit, e përbërë nga një gjyqtar i vetëm dhe në mbështetje të gjetjeve të ekspertit për vendndodhjen e ish-çerdhes në tokën e trashëguar nga R., pronësia e të cilit kontestohej nga kërkuari, gjykoi se R.-së i ishte dhënë e drejta e parablerjes ndaj godinës dykatëshe. Ajo e deklaroi të pavlefshme kontratën për shitjen e pronës të kërkuarit, duke konstatuar se kontrata ishte lidhur në shkelje të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore për arsytet e mëposhtme: i) çerdhja nuk ishte kthyer në njësi banimi; ii) kërkuari nuk kishte qenë qiramarrës; iii) legjislacioni përkatës e kishte humbur forcën e tij ligjore në momentin kur ishte lidhur kontrata e shitblerjes. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit urdhëroi që regjistrimi kadastral të hiqej nga regjistri i ZRPP.

6. Kërkuari apeloj në Gjykatën e Apelit, ku trupa gjyquese përbëhej nga gjyqtarët P.K., T.S. dhe M.Q. Pasi kërkuari kërkoj pa sukses përjashtimin e T.S. dhe M.Q., Gjykata e Apelit e rrëzoi apelin e tij më 4 maj 2004. Pas rrëzimit të apelit të tij të mëpasshëm nga Gjykata e Lartë, kërkuari paraqiti një ankesë në Gjykatën Kushtetuese. Ai theksoi, midis të tjerash, se në procedurat e mësipërme të ndërmarra nga R., atij i ishte mohuar statusi i palës së akuzuar, dhe kjo në shkelje të parimit të barazisë së armëve, dhe se gjyqtarët të cilët ishin pjesë e trupës gjyquese të Gjykatës së Apelit kishin marrë një vendim kundër tij me herët, në një çështje tjetër në lidhje me të drejtat e tij pronësore (shih paragrafin 3 më sipër). Gjithashtu, kërkuari paraqiti një ankesë tjetër mëveçantë, sipas së cilës Gjykata e Rrethit nuk duhej ta kishte dhënë vendimin me një gjyqtar të vetëm.

7. Me 16 janar 2006, Gjykata Kushtetuese, me anë të një vendimi me shumicë, të arsyetuar, nuk konstatoi asnjë shkelje ndaj të drejtave kushtetuese të kërkuarit. Ajo e rrëzoi ankesën e kërkuarit për çështjen e tij në Gjykatën e Rrethit e cila ishte gjykuar nga një gjyqtar i vetëm, me arsyetimin se nuk ishin shteruar mjetet vendase. Gjithashtu, ajo gjykoi se kërkuari ishte dëgjuar në mënyrë të drejtë, kishte marrë pjesë plotësisht gjatë procedurave sipas parashikimeve në ligjin vendas, dhe se kërkesat e tij ishin dëgjuar dhe shqyrtuar nga gjykatat përkatëse. Veçanërisht, ankesa ku pretendohet për anshmëri nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit ishte rrëzuar me arsyetimin se procedurat kishin palë të ndryshme dhe kishin një lëndë tjetër, të ndryshme nga procedurat e ndërmarra nga L.

8. Në procedurat në vijim për kompensim pas shpalljes si të pavlefshme të kontratës së kërkuarit për blerjen e apartamentit dhe të tokës përkatëse, më 15 qershor 2006, Gjykata e Rrethit e pranoi kërkesën e kërkuarit për, midis të tjerash, rimbursimin e çmimit të blerjes. Për pasojë, gjykata urdhëroi Bashkinë e Sarandës t'i paguante kërkuarit çmimin e blerjes prej 189,000 lekësh si edhe 4,134,900 lekë (rreth 31,960 euro në atë kohë), për kostot e bëra për punimet në apartament dhe mirëmbajtjen e tij. Në vijim, ajo vendosi se kërkuari do të qëndronte në apartament derisa të shlyheshin plotësisht shumatat e mësipërme.

#### VLERËSIMI I GJYKATËS

##### I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

9. Kërkuari paraqiti një sërë ankesash në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës. Në lidhje me procedurat e ndërmarra nga L. dhe R., ai u ankua se i ishte mohuar statusi i të akuzuarit në shkelje të parimit për barazinë e armëve. Në lidhje me procedurat e paraqitura nga R., ai u ankua se, duke iu referuar vlerës së padisë së tij, Gjykata e Rrethit nuk kishte qenë kompetente ta shqyrtonte çështjen me një gjyqtar të vetëm. Gjithashtu, ai u ankua për anshmëri nga ana e trupës gjyquese të

Gjykatës së Apelit e cila kishte dhënë vendimin e datës 4 maj 2004, për shkak të përfshirjes së mëparshme të gjyqtarëve në procedurat e ndërmarra nga L.

**A. Shkelje e pretenduar e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë "e krijuar nga ligji"**

10. Duke theksuar se Gjykata mund ta shqyrtojë një çështje pasi janë shterura të gjitha mjetet vendase, ajo vëren, ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj të datës 16 janar 2006, se kërkuksi nuk kishte paraqitur ndonjë kundërshtim përpara Gjykatës së Rrethit për shqyrtimin e çështjes së tij nga një gjyqtar i vetëm.

11. Ajo vijon se kjo ankesë duhet të kundërshtohet, në mbështetje të Nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës, për mosshërim të mjeteve vendase.

**B. Shkelje e pretenduar e barazisë së armëve**

12. Parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me garantimin e barazisë së armëve parimisht zbatohen si për çështjet civile edhe për ato penale dhe janë përdorur në vendimet *Kress kundër Francës* ([DHM], nr. 39594/98, § 72, GJEDNJ 2001-VI), *Yvon kundër Francës* (nr. 44962/98, § 31, GKJEDNJ 2003-V), *Gorraiz Lizarraga dhe Të Tjerët kundër Spanjës* (nr. 62543/00, § 56, GJEDNJ 2004 III) dhe *Gregaćević kundër Koracisë* (nr. 58331/09, § 50, 10 korrik 2012).

13. Në lidhje me ankesën e kërkuksit për shkelje të barazisë së armëve në procedurat e ndërmarra nga L., vendimi i formës së prerë sipas interpretimit të Nenit 35 § 1 të Konventës është ai i datës 17 qershor 2003, ndërsa kërkesa e tij në Gjykatë u paraqit më 5 prill 2006. Për këtë arsye, kjo ankesë është paraqitur përtej afatit gjashtëmuor dhe në këtë mënyrë duhet të rrëzohet si e papranueshme në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

14. Në lidhje me ankesën e kërkuksit për shkelje të barazisë së armëve në procedurat e ndërmarra nga R., Gjykata vëren se kërkuksi mori pjesë në procedurat ndaj Komisionit dhe më pas ndaj AKS si palë e tretë, duke qenë se ato institucione ishin në pozicionin e të akuzuarit. Kërkuksi pati akses në dosjen e çështjes dhe në të gjithë dokumentet në të, u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur prej tij, bëri apelime në gjykatat më të larta dhe kundërshtoi raportet e ekspertëve të cilët ishin në disfavorin e tij.

15. Duke marrë në konsideratë rrethanat përkatëse – më konkretisht, se kërkuksi shfrytëzoi hapat proceduralë në dispozicion për palët e treta, se ligji procedural, sipas interpretimit nga Gjykata e Lartë, i ndalonte gjykatat vendase të kërkonin dhe të thërrisnin një palë si e akuzuar, dhe se ligji procedural parashikonte mundësinë që një palë e tretë të ndërhynte si ndërhyrësi kryesor dhe të paraqiste një kërkesë ndaj njëres ose të dyja palëve fillestare në procedura – Gjykata konstaton, ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese, se nuk mund të thuhet se kërkuksi ishte vendosur në një disavantazh të madh *vis-à-vis* ndaj paditësit. Fakti se Gjykata e Rrethit mori në shqyrtim faktin nëse kundërpadia e kërkuksit duhej të merrej në konsideratë dhe e rrëzoi kërkesën e tij në të njëjtat procedura, nuk e ndryshon përfundimin e mësipërm.

16. Në mbështetje me rrethanat, kjo ankesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

**C. Pretendimi për mungesë të paanshmërisë së trupës së Gjykatës së Apelit e cila mori vendimin e datës 4 maj 2004**

17. Gjykata thekson parimet e përgjithshme që u përmbledhën në vendimin *Morice kundër Francës* ([DHM], nr. 29369/10, §§ 73-78, 23 prill 2015).

18. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata e konsideron të rëndësishme që të adresohet qëllimi i vendimeve të marrë nga gjyqtarët P.K., T.S. dhe M.Q. në dy grupet e procedurave të ndërmarra nga L. Dhe R., respektivisht.

19. Në procedurat e ndërmarra nga L., si në shkallën e parë dhe në apel, gjyqtarët përcaktuan meritat e kërkesave të L. për rikthimin *in natura* të një trualli që rrethonte një ish-çerdhe. Ata vendosën në favor të kërkesave të L., duke konstatuar se kërkuksi nuk e kishte përvetësuar truallin në fjalë në kohën kur u privatizua çerdhja. Edhe pse koha e privatizimit kishte lidhje me ato procedime, Gjykata vëren se pronësia e apartamentit nga kërkuksi (apartament i cili ishte pjesë e ndërtesës së çerdhes) dhe trualli përkatës nuk ishte subjekti i procedurave. Në një grup mëveçantë procedurash, në vendimin e datës 4 maj 2004, Gjykata e Apelit, e përbërë nga të

njëjtët gjyqtarë, P.K., T.S. dhe M.Q., përcaktoi meritat e kërkesës së R. Për ish-çerdhen dhe truallin përkatës. Trupa gjyquese mbështeti kërkesat e R. dhe mori një vendim kundër kërkuessit (shih paragrafët 3 dhe 6 më sipër).

20. Në këto rrethana, Gjykata bie dakord me Gjykatën Kushtetuese se dy grupet e procedurave ishin ndërmarrë nga paditës të ndryshëm dhe kishin të bënin me lëndë të ndryshme. Sipas gjykimit të Gjykatës, vendimet specifike të gjyqtarëve P.K., T.S. dhe M.Q. dhënë në grupin e parë të procedurave, paraqitur nga L., nuk mund të konsiderohen se justifikojnë në mënyrë objektive shqetësimet e kërkuessit për anshmëri të gjyqtarëve në grupin e dytë të procedurave të ndërmarra nga R. (krahaso *Golubović kundër Kroacisë*, nr. 43947/10, §§ 53-60, 27 nëntor 2012).

21. Si përfundim, kjo ankesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

## II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENOT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

22. Gjykata konstaton se vendimet vendase, të cilat e shpallnin të pavlefshme deklaratën e blerjes të lidhur nga kërkuessi, përbënin një ndërhyrje në të drejtat pronësore të kërkuessit. Kjo përbënte një “privim” nga prona sipas kuptimit të fjalisë së dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

23. Gjykata vëren se kontrata e blerjes u deklarua e pavlefshme sepse ajo ishte lidhur në shkelje të legjislacionit përkatës për strehimin, për arsye të detajuara në vendimet vendase, të cilat kërkuessi nuk i ngriti për diskutim gjatë procedurave vendase ose gjatë procedurave në Strasburg. Në këto rrethana, Gjykata nuk ka arsye që të verë në dyshim ligshmërinë e vendimeve të gjykatave vendase ose konstatimet e tyre dhe interpretimin e ligjit vendas. Gjithashtu, Gjykata e Apelit njohu të drejtën e R. për parablerje në lidhje me ndërtesën dykatëshe. Sipas mendimit të Gjykatës, një gjë e tillë ishte në përputhje me qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave legjitime të pronarëve.

24. Për sa ka të bëjë me çështjen nëse kërkuessi i ishte kërkuar të mbante një “barrë joproporcionale”, Gjykata konstaton se kërkuessi nuk u ankua për faktin se – pasi shitja u deklarua e pavlefshme – ai e gjeti veten në një situatë veçanërisht vulnerabël për sa i përket strehimit (shih *Padalevičius kundër Lituanisë*, nr. 12278/03, § 71, 7 korrik 2009), dhe gjithashtu ai nuk bëri as ndonjë ankesë për pamjaftueshmëri të kompensimit (shih, *mutatis mutandis*, *Mohylova kundër Republikës Çeke* (vendim), nr. 75115/01, 6 shtator 2005). Në të vërtetë, në një grup të mëpasshëm procedurash, kërkuessi iu rimbursua çmimi i blerjes, mori shpërblimet, dhe u autorizua të mbante pronësinë e apartamentit deri në shlyerjen e plotë të shumave që i ishin akorduar (shih paragrafin 8 më sipër). Në lidhje me mbrojtjen procedurale të interesave të kërkuessit, Gjykata vëren se gjatë procedurave vendase ai kishte mundësinë për procedura kundërshtuese. Kërkuessi u përfaqësua rregullisht gjatë procedurave dhe pati mundësi të shumta për të paraqitur të gjithë argumentet të cilat ai i konsideronte të rëndësishme për rezultatin e çështjes.

Për këtë arsye, ndërhyrja në të drejtat pronësore të kërkuessit ishte proporcionale (shih *Bogdel kundër Lituanisë*, nr. 41248/06, §§ 63-68, 26 nëntor 2013).

25. Sipas rrethanave, kjo ankesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

*E deklaron* vendimin të papranueshëm.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 10 nëntor 2022.

**Olga Chernishova**  
Zëvendësregjistrare

**Andreas Zünd**  
Kryetar